VENDIM
Nr. 81, datë 9.6.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa "ç" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, pika 1, germa "f"; 5, pika 1, germa "f" dhe nenit 13 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti